

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

I. HYRJE.

Industria e përpunimit dhe e prodhimit të lëkurës dhe e prodhimit të këpucës ka pasur rëndësi të veçantë për ekonominë e Shqipërisë, gjatë periudhës 1960-1990. Bazuar në modelin e ekonomisë së centralizuar, vendi zhvilloi një aktivitet prodhues dhe tregtues, duke filluar nga sigurimi i lëndëve të para, ai i lëkurës së përpunuar dhe të regjur, deri te strukturat e prodhimit të plotë. Rrethi ishte i mbyllur dhe prodhimi synohej për tregun vendas, duke përmbyshur, plotësisht, të gjitha kërkesat e tij.

Mbas viteve 1990, sipërmarrjet e përfshira në grumbullimin dhe prodhimin e produkteve të lëkurës dhe të këpucëve u privatizuan dhe, në shumicën e rasteve, ato e ruajtën destinacionin e tyre. Megjithatë, vetëm një pjesë e këtij zinxhiri u vendos përsëri në funksion, kryesisht, për kërkesën që vinte, më së shumti, nga Italia për nënkontraktimin e shërbimeve në Shqipëri, në formën e industrisë fasone.

Sektori i prodhimit të lëkurës dhe i këpucës, në vendin tonë aktualisht është një sektor i rëndësishëm për ekonominë e vendit.

Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 2019 numëroheshin, 245 fabrika të prodhimit të këpucëve, me një total të punësuarish prej më tepër se 25600 persona, ose rreth 6% të totalit të punësimit në vend.

Industria e prodhimit të lëkurës dhe këpucës në vend zotëron rreth 20% të totalit të eksporteve, me 480 milionë euro në vit (në vitin 2019).

Aktualisht, disa prej produkteve më të eksportuara për sektorin e këpucës, janë: çizme, këpucë gjimnastike, këpucë klasike, këpucë me taka, atlete futbollit dhe sportive, sandale, shapka, këpucë alpinizmi, këpucë sigurimi, ortopedike për trajtimin e patologjive skeletike, pantofla.

Zhvillimi i këtij aktiviteti prodhues dhe tregtar, ka disa përparësi positive të cilat po i listojmë, si më poshtë:

- Krahu i lirë i punës;
- Afërsia gjeografike me tregjet europiane;
- Eksperienca pozitive, shumëvjeçare, me firmat më të njohura europiane;
- Fleksibilitet në rastin e porosive të mëdha dhe të vogla;
- Fuqi punëtore e kualifikuar;
- Dërgesa të shkurtra në kohë në vendet e BE-së;
- Kosto relativisht e ulët e transportit në Europë;
- Aftësi të shkëlqyera të gjuhës së huaj;
- Politika mbështetëse të qeverisë dedikuar këtij sektori.

Shqipëria gëzon të drejtën e disa marrëveshjeve për tregti të lirë, si: CEFTA 2006, EFTA, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë mes Turqisë dhe Shqipërisë, anëtarësimi WTO etj.

Subjekti MARLET 2012 SH.P.K. është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti L233144031.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: FIER, Lagja Kryengritja e Fierit, ish Uzina e Pambukut.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: *“Prodhimi për vete dhe për të tretë, të këpucëve të mbaruara ose, pjesë të tyre, çanta, rripa dhe çdo prodhim tjetër lëkure. Montimi dhe tregtimi i materialeve për prodhimin e këpucëve ose të çdo prodhimit tjetër prej lëkure.*

Administratori i këtij subjekti është znj. Maria Letizia Laporta me afat emërimi nga: 20.12.2022 deri 20.12.2027

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me **ID 7.12** Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve: Pika 0, **Prodhimi i këpucëve**. kapaciteti i prodhimit:

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundëshme në mjedisin epunës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshmë i kësaj veprimtarije, vlersuar nga pikpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlersuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlersimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjen reale e zhvillimit të kësaj veprimtarije nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.

- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar)..
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (i ndryshuar).

- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”.
- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhrin e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

Linja teknologjike e instaluar dhe funksionale në këtë subject, bën të mundur realizimin e proceseve të suksesshme të prodhimeve të caktuara me cilësi të vlersueshme dhe konkurente në tregun e këtyre artikujve. Makineritë dhe pajisjet e instaluar janë, bashkëkohore kryesisht të importuara nga vendet e B.E.-së. Këto makineri dhe pajisje bashkëkohore vlersohen miqsose me mjediset e vendeve të punës dhe më gjërë.



	X	Y
1	4509975.01	4377822.06
2	4509949.11	4377865.21
3	4509938.67	4377857.36
4	4509963.96	4377818.25

Në vijim po paraqesim disa prej makinerive kryesore të instaluara në këtë subjekt:

- ❖ Makineritë prerëse.
- ❖ Makineritë e premontes.
- ❖ Makineritë e shkajimit.
- ❖ Makineritë e manovisë së montimit.
- ❖ Frigoriferi i këpucëve.
- ❖ Furra ku piqet mastiçi.

Linja teknologjike e prodhimit të këpucëve është e organizuar dhe e shpërndarë në punën e disa reparteve prodhues, të vendosur sipas skemës teknologjike e cila paasqyrohet në vijim.

- a. Reparti/proçeset e prestarisë.
- b. Reparti/proçeset e shkajimit.
- c. Reparti/proçeset e qepjes në makinat e specializuara.
- d. Reparti/proçeset e qepjes me dorë.
- e. Reparti/proçeset e montimit.
- f. Reparti/proçeset e paketimit dhe ambalazhimit.

a. Reparti/proçeset e prestarisë.


Lëkura është lënda e parë kryesore për realizimin e këpucëve të llojeve të ndryshme. Kështu që, tregohet kujdesi maksimal për kontrollin dhe përgatitjen e saj për t'ju nënshtruar proceseve teknologjike, të caktuara. Në këtë repart kryhen tre proçese bazë:


- ❖ Ndarja e lëkurës në tre kategori cilësi (në vartësi të porosive të klientit).

- ❖ Prgatitja e boletave së bashku me urdhërat përkatës të shoqëruar me sasi të e lëkurës të përcaktuara në boletë dhe në skendën teknike.
- ❖ Prerja e lëkurës. Ky process kryhet zakonisht nga punëtorë me ekesperincë. Fustelat vendosen mbi një syrprinë plastike, mbi të cilën është vendosur lëkura që do të pritet. Lëkura është zendosur mbështetur mbi skemën e prerjes së modelit përkatës, të ndërtuar në mënyrë të tillë që të arrihet shfrytëzimi maksimal i lëkurës. Gjithsesi, gjatë zhvillimit të procesit të prerjes, kemi një sasi lëkure e cila nuk mund të përdoret dhe, që emërtohet humbje teknologjike e këtij procesi. Sasia e lëkurës që shkon si humbje teknologjike, është e kondicionuar nga faktorët që pasqyrohen në vijim:
 - Difekte që shoqërojnë lëkuras si psh ngjyra, maeriali, trashësi, etj.
 - Mbetje nga konfiguracioni i modelit që egzekutohet dhe formës gjeometrike të vetë lëkurës.
 - Niveli teknik i punëtorit.

Krahas prerjes së lëkurës, në këtë repar priten edhe materilae të tjerë si astare të llojeve të ndryshme, goma poroze, material/lëndë rificuese, shtesa të ndryshme (sottopitd), llastiku etj. Mbetjet teknologjike të të gjithë lëndëve/material që i nënshtrohen procesit të prerjes rezultojnë në vlerat 30-33 %, të sasisë së përgjithshme respektive të lëndëve/material që futen në këtë proces.

SKEMA TEKNOLOGJIKE.





b. Reparti/proçeset e shkajimit.

Proçesi teknologjik i shkajimit të lëkurës ka të bëjë me barazimin/sheshimin e saj, në të gjithë pjesët. Ky proçes kryhet me anë të makinerive të profilizuara.

c. Reparti/proçeset e qepjes në makinat e specializuara.

Proçeset e qepjes të syrprinave dhe pjesëve të tjera të këpucëve, bëhet në makinat e specializuara. Gjatë kryerjes së këtij proçesi, qepen edhe aksesorët përkatës.

d. Reparti/proçeset e qepjes me dorë.

Në këtë repart, kryhet qepja me dorë e shuallit me syprinën e këpucës. Në përfundim të proçesit të qepjes me dorë, kryhet kontrolli teknik I produktit dhe ai kalon në repartin e montimit.

e. Reparti/proçeset e montimit.

Proçesi i montimit fillon me shtrimin e manovisë, duke zbatuar urdhërat e punës me forma plastike dhe produktin e përfunduar.

Më pas vazhdohet me proçesin e futjes në kallëp të këpucëve, në makinerinë premonte. Gjatë zhvillimit të këtij proçesi, mund të ndodhë dëmtim i lëkurës për shkak të tërheqjes. Nëse ndodh kjo, ripriten pjesët e dëmtuara dhe bëhet qepja përsëri e syprinës së këpucës, për të vazhduar

më tej me lyerjen e saj me mastic dhe injektimit te shola e këpucës. Më pas këto këpucë futen ne furrë përkatëse.

Në përfundim të procesit, këpucët nxirren nga furra dhe kalojnë në frigorifer dhe në proceset e Ilustrimit dhe të shkëlqimit.

Këpucët mbahen në frigorifer deri në temperaturën -16°C .

f. Reparti/proceset e paketimit dhe ambalazhimit.

Produktet përfundimtare i nënshtrohen kontrollit teknik, individual. Nëse gjitha çka është brenda parametrave teknik, këpucët futen në kuti kartonii, në të cilat është vendosur një etikë e cila tregon numurin dhe ngjyrën e këpucës. Nëse nga kontrolli , rezultojnë këpucë me difekte të ndryshme ato, i nështrohen procesit të riparimit të këtyre difekteve.

Këpucët normale, të vendosura në kutitë respective, inventarizohen dhe shkojnë në magazinën përkatëse ku vendoset në kuti kartoni më të mëdha, të cilat mbajnë 4 deri 15 palë (kuti të vogla).

Këtu mbyllet cikli i prodhimit dhe ky produkt është i gatshëm për treg.

IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

4.1. Lëndët e para.

Prodhimet e këtij subjekti bëhen duke përdorur lëndë të parë, lëkura të llojeve të përcaktuara, të cilat vijnë nga importi, së bashku me aksesorët apo lëndët ndihmëse të nevojshme për realizimin e këtyre produkteve. Materilet e importuara janë të shoqëruara me çertifikatat origjinale të cilësisë. Ato i nënshtrohen regjimit doganor, sipas të gjitha procedurave ligjore të vendit tonë.

Njeriu e ka përdorur lëkurën në jetën e përditshme që nga kohërat e lashta. Pas një ose më shumë metodash përpunimi, lëkura e një kafshe mund të përdoret përdorej për të bërë rroba, këpucë, pajisje, mbulesa dhe disa pjesë për armë, si dhe disa elementë të armaturës ushtarake. Shkenca e rregjijes/përpunimi të lëkurave është zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht gjatë shekujve. Ashtu si çdo fushë tjetër e veprimtarisë njerëzore, prodhimi i lëkurës përdor terminologjinë e vet të veçantë.

Lëkura është një material i fortë dhe i qëndrueshëm. Ka veti të mira mbrojtëse, është elastik dhe i qëndrueshëm me kujdesin e duhur. Estetikisht tërheqëse, mund t'i japë gjërave edhe të sofistikuara elegante dhe pamje të besueshme të rënda.

Llojet e lëkurave që përdoren për prodhimin e syprinave, janë të buta dhe kompakte, ndonjëherë edhe elastike.

4.2. Lëndët ndihmëse.

Ndër lëndët mbihmëse që përdoren për prodhimin e këpucëve mund të përmendim: astar, fill qepjeje, përforcues, mastiç, ilustrues, sfungjer, zinxhira, forcues themrash, forcues majash, pasatina, ngjyrat kremërat dhe materiale të tjera pastrimi, etj.

✓ **Fillërat e qepjeve.**

Përgjithësisht përdoren fillëra prej pambuku. Në raste të veçanta përdoren edhe fillëra prej nejloni. Përdorimi i llojit të fillit, kondicionohet nga lloji i këpucës që do prodhohet.

✓ **Ngjyrat kremërat dhe materiale të tjera pastrimi.**

Janë materiale të cilët përdoren në proceset përfundimtare të prodhimit të këpucës. Ngjyrat janë kryesisht me bazë dylli dhe vetë-Ilustrimi, kremi ndihmon për ti bërë këpucët me pamje me të këndëshme sepse i jep atyre shkëlqim.

✓ **Aksesorë të ndryshëm(guarnicionet, fibrat, morselati etj.).**

Përdorimi i këtyre aksesorëve është i kondicionuar nga lloji i prodhimit që realizohet si dhe kërkesat e konsumtarëve, mbështetur në ligjet për sigurinë dhe kompozicionin e materialit.

✓ **Përforcues.**

Janë të gjithë llojet e elementëve/materialeve të cilët mbështesin syprinën e këpucës, në pikat/pjesët në të cilët i nënshtrohen tensioneve të forta. Këto materiale janë adekuatë, të ngurta ose të butë në vartësi të llojit të lëkurës që duhet përforcuar.

✓ **Ngjitësit.**

Ngjitësit janë lëndë/substanca të cilat kanë veti ngjitëse/bashkuese të dy materiale të ndryshëm. Termi adesiv, përdoret gjërësisht për substancat me origjinë sintetike ndërsa, termi col, përdoret për substancat me origjinë natyrore.

4.3. Energjitë që përdoren.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria e prodhimit të këpucëve është i lidhur me rrjetin einxhinjerik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjerik janë, ai i :

- ✓ Furnizimit me energji elektrike.
- ✓ Furnizimit me ujë të pijshëm.
- ✓ Shkarkimit të ujrave të ndotur.

a. Furnizimi me energji elektrike.

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energjie elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatës me OSSHE e kësaj zone. Brenda objektit është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon rrymën elektrike në të gjitha pikat konsumatore të saj. Energjia elektrike përdoret kryesisht për ndriçimin e ambjneteve të punës, rrugëve etj. Fuqia elektrike e instaluar në këtë karrierë është rreth 125 kWh.

b. Furnizimi me ujë.

Uji nuk është pjesmarrës në proceset teknologjike që zhvillohen në këtë veprimtari të prodhimit të këpucëve. Ai përdoret kryesisht për plotësimin e nevojave humane. Konsumi mesatar mujor i ujit shkon në rreth 12 m³.

c. Përdorimi i lëndës djegëse, naftë.

Për të plotësuar nevojat e transportit të brendshëm të subjektit si psh lëvizjen e punonjësve (marrjen dhe largimin nga puna), ngarkimin e produktit në mjetet e transportit, si dhe shkarkimin e lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse, për automjete transporti si dhe ngjitëse e transportuese të cilat punojnë me lëndë djegëse naftë. Nafta, blihet në subjekte të liçensuar për magazinimin dhe tretimin e saj. Konsumi naftës shkon mesatarisht në rreth 350 litra/muaj.

V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të prodhimit të këpucëve, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

5.1. Shkarkime në ajër.

Proçesi teknologjik i prodhimit të këpucëve, përfshin edhe proçesin e ngrohjes dhe të përdorimit të mastiçit si dhe atë të ngrohjes së këpucës gjys-prodakt, në furrat përkatëse. Gjatë zhvillimit të këtyre proçeseve nga pajisjet respective çlirohen dhe shkarkohen lëndë volatile. Për largimin nga vendet e punës të këtyre gazeve volatile, pranë këtyre pajisjeve janë instaluar kapa thithëse. Pjesë përbërëse e këtyre kapave thithëse janë aspiratorët e instaluar në to si dhe, sistemet e tubacioneve dhe oxhakut, duke bërë bëjnë të mundur kështu, jo vetëm largimin e këtyre gazeve nga vendi i punës por, edhe shkarkimin e tyre në atmosferë.

5.2. Shkarkime në tokë.

Zhvillimi i kësaj veprimtarie nuk shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë. Në rubrikat paraardhëse treguam se, prodhimtaria e këpucëve shoqërohet me një sasi që shkon deri në 30-35 %, mbetje teknologjike e ngurtë në përbërje të së cilës janë copra lëkure, shoresh, penjesh, etj. e gjithë kjo sasi mbetjesh teknologjike, grumbullohet në kuti kartoni dhe vendoset në një vend të caktuar Brenda teritorit që administrohet ky subjekt.

Dukeqënëse, ky subjekt punon me regjim doganor, përfaqësues të doganës vlersojnë dhe inventarizojnë këto mbetje teknologjike duke plotësuar dokumentacion ligjor përkatës. Kështu vlersohen dhe rakordoren, sasi të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse që janë importuar, sasi të produkteve dhe sasi të mbetjeve teknologjike të rezultuara, për një periudhë pune të përcaktuar. Në përfundim të këtij vlersimi dhe plotësimi të dokumentacionit ligjor respektiv, bëhet asgjësimi i këtyre mbetjeve teknologjike.

5.3. Shkarkime të ujrave të ndotur.

Proçeset teknologjike të prodhimit të këpucëve nuk kërkojnë përdorimin e ujit. Kështu, sasia e ujit të përdorur nga ky subjekt është vetëm për plotësimin e nevojave humane të punonjësve. Përfundimisht nga ky subjekt, ujrato që shkarkohen janë të ndotur nga pluhurat dhe mbetje të tjera që mbartin gjatë pastrimit të ambjenteve të punës si dhe ujra të zeza.

5.4. Shkarkime të zhurmave.

Gjatë punës të pajisjeve/makinerive që kryejnë proçese të ndryshme teknologjike, për prodhimin e këpucëve, në afërsi të këtyre makinerive/pajisjeve (në vendet e punës) janë të pranishme zhurmat. Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Subjekti MARLET 2012 SH.P.K. me NIPT L23314403I, ushtron veprimtarinë e prodhimit të këpucëve në qytetin e Fierit.

Fieri shtrihet në pjesën qendrore– perëndimore të Shqipërisë, në jug të fushës së Myzeqesë dhe ndodhet 18 km larg bregut të detit Adriatik. Bashkia e Fierit gëzon një pozitë gjeografike dhe strategjike të favorshme. Ajo ka një sipërfaqe prej 619.90 km² dhe përbëhet nga 10 njësi administrative.



Teritori nën administrimin e kësaj bashkije, karakterizohet si një terren fushor me lartësi mesatare prej 20 metra mbi nivelin e detit dhe kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnje, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë. Në territorin e bashkisë gjenden toka shumë pjellore. Bashkia Fier (pas ndarjes territoriale 2015) ka një vijë bregdetare të konsiderueshme rreth 27 km, nga grykëderdhja e lumit Vjosë deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufijtë e parkut kombëtar Divjakë-Karavasta.

Nëpër këtë territor të saj, kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit: korridori VIII dhe korridori i kaltër (autostrada Adriatiko-Joniane).

Ajo përfshin disa nga zonat bujqësore më të rëndësishme të vendit, si dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës. Kufizohet nga dy lumenj kryesor, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëron parkun arkeologjik kombëtar të Apolonisë; si dhe trashëgon

zona industriale dhe naftëmbajtëse si dhe gëzon pozicionim strategjik avantazhues përse i përket gazifikimit të mundshëm, me vënien në zbatim të gazsjellësit TAP që kalon brenda territorit të saj.

Bashkia e Fierit, në bazë të statistikave të vitit 2011 (sipas Censurit) regjistronte 196,324 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile në vitin 2016 regjistron 200,376 banorë (burimi Ministria e Brendshme). Dendësia e popullsisë llogaritet në rreth 316.7 banorë/km². Më shumë se 55 % e popullsisë së bashkisë jeton në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike. Prodhimi bujqësor është i shumëllojshëm nga drithi te zarzavatet, bostanoret, blegtoaria dhe nënproduktet e saj.

Objekti në të cilin zhvillohet veprimtaria e këtij subjekti, gjendet në zonën e ish fabrikës së pambukut. Është një objekt i rikonstruktuar dhe i përshtatur me veprimtarinë që zhvillohet këtu. Ai është i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr. i pikës	Y	X
1	44	45
2	44	45
3	44	45
4	44	45

Trualli i pazënë me ndërtime nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi. Në të ka elementë infrastrukturë si rrjete furnizimi me ujë të pijshëm, rrjete të shkarkimit të ujrave të ndotur, rrjete rrugore etj. kjo edhe për faktin se është pjesë e një ish ndërmarrjeje të përpunimit të pambukut. Ky teritor është jashtë planeve të pushtetit për ndërtimin e objekteve të banimit si dhe infrastrukturës dhe elementëve të saj.

6.1. Përshkrim të faktorëve klimatike.

Qyteti i Fierit ndodhet në zonën e klimës subtropikaale mesdhetarezonë e cila karakterizohet nga një dimër i butë e i lagët dhe verë e nxehtë dhe e thatë.

Temperature mesatare e ajrit në janar është 15 °C ndërsa ajo minimale është -5 deri -7 °C. Në këtë teritorbien rreth 1000 mm shi në vit, kryesisht gjatë stinës së dimrit dhe vjeshtës.

Erërat që fryjnë në këtë rajon janë murlani, shiroku, puhija dhe juga. Murjani është më i ndjeshëm gjatë stinës së dimrit dhe, ka shpejtësi të madhe suke sjellë mot të ftohtë dhe të kthjellët. Shiroku që njihet edhe si era e deteve, fryn në drejtimin juglindor dhe është më i ndjeshëm në vjeshtë dhe në fund të dimrit.

6.2. Përshkrim i përgjithshëm i gjeologjisë dhe hidrogjeologjisë në zonën e projektit.

Teritori i administruar nga Bashkija Fier, shtrihet mbi depozitime kuaternare, ndërsa pjesa juglindore e tij përbëhet nga depozitime të Pliocenit, të cilat shtrihen kryesisht në qendër ndërmjet dy njërive strukturore, ajo lindore Kreshpan-Ardenicë-Divjakë dhe ajo perendimore që është periklinali verior i strukturës së Frakullës.

Kodrat në jug të qytetit janë të ndërtuara nga depozitime pliocenike të suitave “Helmës” dhe “Rrogzhina” të cilat përputhen me kuota më të larta të relievit. Në rajonin Zhupan-Radostin, këto depozitime zhyten drejt qytetit të Fierit, duke i lënë vend fushë-përhapjes së depozitime kuaternare. Depozitimet kuaternare përfaqsohen nga ato të Holocenit dhe Pleistocenit. Ato përfaqsohen nga argjila, suhargjila, rëra dhe mbeturina trofte. Drejtë perëndimit këto depozitimeshkijnë në origjinë detare.

6.3. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

Rajoni I Fierit është i pasur me ujra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Ky teritor përshkohet nga dy lumenj kryesor, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre.

Teritori i kësaj bashkije, ka një vijë bregdetare të konsiderueshme prej rreth 27 km, nga grykëderdhja e lumit Vjosë deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufinj të parkut kombëtar Divjakë-Karavasta.

Shtresa nëntokësore ujëmbajtëse, akuiferet ndërkokrrizorë kanë përcjellshmëri të lartë uji, me tregues cilësor të tijë. Këto akuifere, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij teritori.

6.4. Bimesia/flora.

Teritori nën administrimin e kësaj bashkije, karakterizohet si një terren fushor me lartësi mesatare prej 20 metra mbi nivelin e detit.

Në teritorin e kësaj bashkije ka më shumë se 160 ha, të mbuluar me pyje, në të cilët ndeshemi me dushkun, pishën mesdhetare, plepat, shkurret të llojeve të ndryshme etj. Në këtë teritor nuk ka bimë apo specie/lloje që rrezikojnë të zhduken apo të jenë pjesë e listës së kuqe.

Në territorin e bashkisë gjenden toka shumë pjellore, përgjithësisht të kultivuara me lloje të ndryshme kulturash bujqësore. Ndër bimët e arave mund të përmend kultivimin e drithërave, perimeve, bimëve industrial, foragjere etj. Krahas tyre kemi edhe kultivimin e drufrutorëve, ullirit, agrumeve, rrushit etj.

6.5. Fauna e zonës.

Për shkak të kushteve klimaterike si dhe një flore të pasur në shumëllojshmëri, të egër dhe të kultivuar, kemi edhe një faun të pasur me gjallesa të kultivuara dhe të egra. Pjesë e faunës së kultivuar janë gjethët, derri, shpendë të llojeve të ndryshme si dhe të imtat delja e dhija.

6.6. Cilësia e ajrit në zonë.

Zona e Fierit mund të vlersohet dhe kategorizohet si zonë me ndikime në mjedis, si për shkarkimet në ajër, treguesit cilësor të ujrave sipërfaqësorë dhe të atyre nëntoksorë, nivelit të zhurmave etj.

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit në këtë zonë janë nga industria nxjerrëse e naftës, aktivitetet e linjave të ndryshme prodhuese si dhe nga trafiku i rënduar në zonat urbane, gjatë orëve të pikut. Në ajër ka shkarkime të gazeve CO, SO₂, H₂S, CO₂, H₂O, NO_x si dhe plumb, blözë dhe pluhur.

6.7. Niveli i zhurmave në zone.

Sipas Raportit të Gjendjes së MJedisit, nga matjet e kryera në qytetin e Fierit, niveli i zhurmave në disa prej kryqëzimeve të rrugëve kryesore, është mbi normate BE-së.

VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.

Eksperienca disa vjeçare e veprimtarisë së prodhimit të këpucëve, ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave si dhe, menaxhimit të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshi këtu edhe të mbetjeve urbane.

5.1. Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritëshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Proçesi teknologjik i prodhimit të këpucëve, përfshin edhe proçesin e ngrohjes dhe të përdorimit të mastiçit si dhe atë të ngrohjes së këpucës gjys-prodakt, në furrat përkatëse. Gjatë zhvillimit të këtyre proçeseve nga pajisjet respective çlirohen dhe shkarkohen lëndë volatile. Për largimin nga vendet e punës të këtyre gazeve volatile, pranë këtyre pajisjeve janë instaluar kapa thithëse. Pjesë përbërëse e këtyre kapave thithëse janë aspiratorët e instaluar në to si dhe, sistemet e tubacioneve dhe oxhakut, duke bërë bëjnë të mundur kështu, jo vetëm largimin e këtyre gazeve nga vendi i punës por, edhe shkarkimin e tyre në atmosferë.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Gjatë punës të pajisjeve/makinerive që kryejnë proçese të ndryshme teknologjike, për prodhimin e këpucëve, në afërsi të këtyre makinerive/pajisjeve (në vendet e punës) janë të pranishme zhurmat. Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

c. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.

Në rubrikat paraardhëse treguam se, prodhimtarija e këpucëve shoqërohet me gjenerimin e një sasije mbetjesh teknologjike të ngurta, që shkojnë deri në 30-35 %, të sasisë së material që marrin pjesë në realizimin e një sasije të caktuar produkti të gatshëm për treg. Në përbërje të këtyre mbetjeve të ngurta teknologjike janë copra lëkure, shojesh, penjesh, etj. E gjithë kjo sasi mbetjesh teknologjike, grumbullohet në kuti kartoni dhe vendoset në një vend të caktuar brenda territorit që administrohet ky subjekt.

Dukeqënëse, ky subjekt punon me regjim doganor, përfaqësues të doganës vlersojnë dhe inventarizojnë këto mbetje teknologjike duke plotësuar dokumentacion ligjor përkatës. Kështu vlersohen dhe rakordoren, sasi të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse që janë importuar, sasi të produkteve dhe sasi të mbetjeve teknologjike të rezultuara, për një periudhë pune të përcaktuar. Në përfundim të këtij vlersimi dhe plotësimi të dokumentacionit ligjor respektiv, bëhet asgjësimi i këtyre mbetjeve teknologjike.

Mbetjet e ngurta urbane, përbëhen kryesisht nga mbetje të ambalazheve prej letre, kartoni, plastike, qelqi etj. Këto mbetje, shkojnë në kazanët e mbetjeve urbane që gjenden brenda territorit të këtij subjekti dhe, çdo ditë largohen prej aty, drejtë landfillit/inceneratorit të Fierit, nga subjekte të kontraktuar nga Bashkia Fier.

d. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Nuk vlersohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Kemi të bëjmë me një ish zonë industriale, me destinacion zhvillimin e proceseve industriale prej shumë vitesh. Kështu në këtë zonë, ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjerie, rrugësh etj. janë të përfunduara. Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjerie, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

e. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804. dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme" për t'u shpallur "Peizazh i mbrojtur".

f. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e më sipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të këpucëve nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujerave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

5.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si :

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zones.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerie egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimet të identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.
- Përafrohet me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësirë të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkohshëm.

Në rastin tonë, kemi të bëjmë me ndikime të përkohëshme negative të shkarkimeve në mjedis si psh shkarkimi i gazeve, zhurmave etj.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërm dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimi të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të këpucëve, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjejkojmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohëshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të sejcilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedis dhe, nuk mund të çojnë më tej në përkeqsim të treguesve cilësorë aktualë të mjedisit.

IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjerie të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.

- Gjenden lehtësisht persona të arsimuar dhe kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluara si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).

Drejtuesit teknik dhe ligjor të subjektit i kanë kushtuar vëmendje maksimale eliminimit të të gjitha llojeve të mbetjeve të krijuara nga kjo veprimtari. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

a. Mbetje e teknologjike të ngurta, që dalin gjatë proceseve të prerjes, kontrollit teknik etj. Në rubrikat paraardhëse treguam se, prodhimtaria e këpucëve shoqërohet me gjenerimin e një sasije mbetjesh teknologjike të ngurta, që shkojnë deri në 30-35 %, të sasisë së material që marrin pjesë në realizimin e një sasije të caktuar produkti të gatshëm për treg. Në përbërje të këtyre mbetjeve të ngurta teknologjike janë copra lëkure, shoresh, penjesh, etj. E gjithë kjo sasi mbetjesh teknologjike, grumbullohet në kuti kartoni dhe vendoset në një vend të caktuar brenda territorit që administrohet ky subjekt.

Dukeqënëse, ky subjekt punon me regjim doganor, përfaqësues të doganës vlersojnë dhe inventarizojnë këto mbetje teknologjike duke plotësuar dokumentacion ligjor përkatës. Kështu vlerohen dhe rakordoren, sasisë e lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse që janë importuar, sasisë e produkteve dhe sasisë e mbetjeve teknologjike të rezultuara, për një periudhë pune të përcaktuar. Në përfundim të këtij vlersimi dhe plotësimi të dokumentacionit ligjor respektiv, bëhet asgjësimi i këtyre mbetjeve teknologjike.

b. Mbetje urbane të cilat përbëhen nga ambalazhe të letrës, kartonit, plastikës, qelqit, drurit, mbetje ushqimore nga veprimtaria njerzore etj.

Mbetjet e ngurta urbane, përbëhen kryesisht nga mbetje të ambalazheve prej letre, kartoni, plastike, qelqi etj. Këto mbetje, shkojnë në kazanët e mbetjeve urbane që gjenden brenda territorit të këtij subjekti dhe, çdo ditë largohen prej aty, drejtë landfillit/inceneratorit të Fierit, nga subjekte të kontraktuar nga Bashkia Fier.

XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit Europjan, kryesisht në Itali. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njera prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa çënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjije të kontrolluar në nivelet

më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorrëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike. Sistemi i ndriçimit të ambienteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Kështu duhet të pranojmë që persosneli punojës ka fituar eksperiencën e mjaftueshme në realizimin e prodhimeve të përcaktuara si dhe në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjerie (ndërtesë, rrjete inxhinjerie etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojmë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe, për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarije.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundëshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit prodhues në kwtë linjw teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonëshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu proçedura të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proçeseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit finaciari, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, metalike, plastike gome, druri, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirim të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarije nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

ë planet rregulluese urbanistike të Bashkisë Librazhd, kjo zonë vijon të vlerësohet si zonë industriale dhe besojmë se e tillë do të mbetet edhe në prespektën e afërt apo të mesme.

XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkakrimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet në ajër dhe nivelin e zhurmave.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Akresi në vendodhjet e matjeve
Për lëndët volatile ku hyjnë solventët, të shprehur si karbon total.	Çdo 6 muaj	Vende të punës ku kryhen proçeset e përdorimit të ngjitësve të ndryshëm dhe bojrave.
Gaze dhe Ndotës të ngurtë	Çdo 6 muaj	Oxhaku i sistemit të aspirimit.
Niveli i zhurmave	Çdo 6 muaj	Aspiratori i sistemit të aspirimit
		Sektori ku janë instaluar makinat qepëse profesionale

- FUND -



19

Ermed Beqaj
Alupis
 NIPT: L02928204T



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË

NOTER KLEDI F. KËNAÇI
ADRESA 15 TETORI, KASTRIOT
MUÇO, NR.7
TEL: 693573128

KONTRATË QIRAJE

(PASURI TË PALUAJTSHME)

Nr. repertori: 3708

Nr. koleksioni: 1126

Fier më 05/11/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020061950104690113

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



Sot, më datë 05.11.2020, para meje Noter KLEDI F. KËNACI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, 15 TETORI, KASTRIOT MUÇO, NR.7, u paraqit personalisht:

QIRADHËNËS:

Murat Nuredini, atësia Gani, amësia Hanife, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë 11 Janari Nj.1; Nd. 11; Fier; Fier; 9303; Fier, lindur më 07/02/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030831012 dhe nr. personal F70207041U, .

*(këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiradhënës**).*

QIRAMARRËS:

Shoqëria MARLET 2012, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L23314403I, me seli në Fier, me adresë Lagjja Kryengritja E Fierit, Ish Uzina E Pambukut., me Administratore MARIA LETIZIA LAPORTA, e perfaqësuar me prokure të pergjithshme nr. 3328 rep. dhe nr. 2004 kol. Dt. 22.12.2015, bere prane noterit Durim Lekdushi ne Fier nga znj. **Juliana Llapashtica**, e bija e Iljaz, lindur me 12.02.1987, ne Fier dhe banuese ne Fier, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e indetifikuar prej meje noterit me leternjoftim me nr. personal I75212092J.

*(këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiramarrës**).*

Palët kontraktuese me marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, deklarojnë se kanë rënë dakord që në bazë të besimit reciprok, kushteve aktuale të tregut dhe legjislacionit civil Shqiptar; e përkatësisht të neneve 801 e vijues të Kodit Civil; të lidhin këtë Kontratë Qiraje (*këtej e tutje, "Kontrata"*) dhe kërkuan nga unë Noteri hartimin e saj, në përputhje me ligjin, si më poshtë vijon:

OBJEKTILI KONTRATES

Dhenia me qera e pasurise se paluajtshme

Kjo kontrate hartohet ne pajtim me nenet 801-825 te kodit civil.

Pala qeradhenese deklarone se ka ne pronesi nje Pasuri: "**truall dhe objekt (ndertese 2 kate) "**, me numer pasurie **8/295**, te ndodhur ne Lagjen "Kryengritja e Fierit ", Fier, zona kadastrale nr. 8531, pronesine e te ciles e verteton vertetim nga dokumentat hipotekore me nr.205, te leshuar ne date 26.09.2011.

Nga kjo pasuri nje njesi sherbimi me siperfaqe totale 400 (katerqind) m2, ndodhur ne katin e pare dhe te dyte te nderteses pala qeradhenese me vullnetin e saj te lire deshiron qe t'ia jape me qera shoqerise "MARLET 2012" shpk, ne baze te nje marreveshje te bere me pare.

KUSHTET E KONTRATES :

- Afati i dhenies me qera eshte **5 (pese) vjet** dhe efekti ligjor i kesaj kontrate fillon pren dates **05.11.2020** deri me **05.11.2025**, afat i cili mund te perseritet.
- Vlera e qerese do te jete **145 000 (njqind e dyzet e pesemije) leke** ne muaj .
- Vlera e qerese do te likujdohet parapagim cdo muaj nga data 01-05 te cdo muaji.
- Gjate periudhes se qerese, qeramarrresi merr persiper mirembajtjen e ambientit te mesiperm ne te gjitha pjeset perberese te tij .
- Pala qeramarrrese ne objektin e marre me qera, nuk ka te drejte te ndryshoje strukturen dhe aktivitetin e tij pa pelqimin e pronarit .
- Njekohesisht pala qeramarrrese nuk mund ta jap me qera kete prone personave te trete.
- Te gjitha demtimet qe mund te ndodhin per faj te pales qeramarese do te perballohen e zhdemtohen ne favor te pales qeradhenese nga qeramarrresi



Pala qeradhenese e siguron palen qeramarrese nga te tretet ne gezimin dhe perdorimin e lire te ketij objekti .Per cdo rast, per cdo lloj konflikti te mundshem pala qeradhenese merr persiper zgjidhjen e tij . Pala qeramarrese eshte e detyruar qe gjate periudhes se qerase detyrimet per pagesen e dritave, te ujit do ti paguaje ai vete.

Palet kane vendosur qe afati i kontrates te respektohet dhe maredhenia e tyre mund te jete vazhduese .Per cdo rast zgjidhja e kontrates do te behet me marreveshje midis paleve duke u lajmeruar secila pale 60 dite para prishjes se kontrates.

Ne rast se likujdimi nuk behet korrekt sipas dates se caktuar me siper, pala qeradhenese ka te drejte ta zgjidhe kete kontrate .

Ne cdo konflikt te mundshem qe mund te linde mes paleve , zgjidhja eshte konsensusi , ne rast te kundert secili prej tyre ka te drejte ti drejtohet per zgjidhje Gjykates se rrethit .

Me keto terma redaktohet kjo kontrate qeraje ne kater kopje me te njejten vlere origjinale secila, e pasi u lexua ,u kuptua dhe u ra dakort me permbajtjen, u nenshkrua me vullnet te lire dhe pa verejtje perpara meje noterit. Une noteri legalizoj aktin konform ligjit "Per Noterine" Nr.110/2018, dt.20.12.2018, nenet Neni 62/ll; 99 e vijues, dhe e nenshkruaj.

QIRADHËNËS

Murat Nuredini

Murat Nuredini

QIRAMARRËS

Shoqeria "MARLET 2012" SHPK
 Perfaqesuar me prokure nga:

NOTER
KLEDI F. KËNAGI

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

LIBRA KADASTRALE 833 NR. I PASURISE ^{8/295} Vol. 17 Fq. 16

INDEKSI I HARTES FR. - 74 - 05 SHKALLA 1:1000

ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER QRF FIER

BAL. 12. FIERIT, PIG - Sa - K - Ap. 1

B. KUFLIZIMET

V. 7. 8/141 - 142

L. 7. 8/140


J. 7. 8/153

P. 7. 8/91

C. PRONARJET

MURAT MUREDINI

D. Data: 15.9.2011 Ora: 14⁰⁰



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
ZYRA E NOTERISE FIER
NOTERI KLEDI KËNAÇI



Nr. 027 rep. Nr. 274 kol.

**KONTRATE QERAJE
(PASURI E PALUAJTSHME)**

Ne Fier, sot me date **03.03.2018**, para meje noterit Kledi Kënaçi, anetar i dhomes se notereve Vlore, me zyre noteriale ne Fier, Lagjia "15 Tetori", rruga "Kastriot Muço", pallati nr.7, u paraqiten personalisht shtetasit pale ne kontraten e poshteshenuar :

ME CILESINE E PALES QERADHENESE :

EDMOND GJOLEKA, i biri i Kamber, lindur me 21.03.1960, ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noterit me leternjoftim me nr. 024394321.

ME CILESINE E PALES QERAMARRESE :

SHOQERIA " MARLET 2012 " shpk, me seli ne Fier, me NIPT Nr. L233144031, e perfaqesuar nga administratorja e saj Znj. **Maria Letizia La Porta**, e bija e Francesko, lindur ne Tuglie, Lece, Itali, me date 28.09.1961, dhe banuese residente ne ne Casarano, Lece, Itali, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me shtetesi italiane, e identifikuar prej meje noterit me pasaporte Italiane nr. A304830, e cila deklaroi se eshte njohese e mire e gjuhes shqipe.

OBJEKTI I KONTRATES

Dhenia me qera e pasurise se paluajtshme

Kjo kontrate hartohet ne pajtim me nenet 801-825 te kodit civil.

Pala qeradhene se deklaroi se ka ne pronesi te saj kete pasuri: " truall dhe ndertese (depo nr. 16-17) " me numer pasurie 8/175, me siperfaqe ndertimi prej 504 m2 (peseqind e kater), te ndodhur ne Lagjen " Kryengritja e Fierit ", Fier, zona kadastrale nr. 8531, vol. 8, faqe 69, pronesine e te ciles e verteton me vertetim nga dokumentat hipotekore me nr. 685, leshuar ne date 05.07.2007.

Kete ndertese me siperfaqe 504 m2, pala qeradhene se me vullnetin e saj te lire deshiron qe t'ia jape me qera Shoqerise " MARLET 2012" shpk, ne baze te nje marreveshje te bere me pare.

KUSHTET E KONTRATES

- Afati i dhenies me qera eshte **5 (pese) vjet** dhe efekti ligjor i kesaj kontrate ka filluar prej dates **01.03.2018** deri me **01.03.2023**, afat i cili mund te perseritet.
- Vlera e qerese do te jete **130 000 (njqind e tridhjetemije) leke** ne muaj .
- Vlera e qerese do te likujdohet parapagim nje here ne muaj, nga data 1-5 te cdo muaji.
- Gjate periudhes se qerese, qeramarresi merr persiper mirembajtjen e ambientit te mesiperperm ne te gjitha pjeset perberese te tij .
- Pala qeramarrese ne objektin e marre me qera, nuk ka te drejte te ndryshoje strukturen dhe aktivitetin e tij pa pelqimin e pronarit .
- Njekoheisht pala qeramarrese nuk mund ta jap me qera kete prone personave te trete
- Te gjitha demtimet qe mund te ndodhin per faj te pales qeramarrese do te perbalohen e zhdemtohen ne favor te pales qeradhene se nga qeramarresi.
- Pala qeradhene se e siguron palen qeramarrese nga te tretet ne gezimin dhe perdorimin e lire te ketij objekti. Per cdo rast, per cdo lloj konflikti te mundshem pala qeradhene se merr persiper zgjidhjen e tij .

Edmond Gjoleka

[Signature]


- Pala qeramarrese eshte e detyruar qe gjate periudhes se qerases detyrimet per pagesen e dritave dhe te ujit do ti paguaje ajo vete.
- Ne rast se likujdimi nuk behet korrekt, sipas dates se caktuar me siper, pala qeradhenese ka te drejte ta zgjidhe kete kontrate menjehere.
- Gjithashtu pala qeradhenese ka te drejte te zgjidhe menjehere kete kontrate ne menyre te njeanshme ne rast se pala qeramarrese nuk likujdon pagesat mujore qe lidhen me detyrimet e energjise elektrike dhe te ujit.
- Palet kane vendosur qe afati i kontrates te respektohet dhe maredhenia e tyre mund te jete vazhduese. Per cdo rast zgjidhja e kontrates do te behet me marreveshje midis paleve .
- Ne cdo konflikt te mundshem qe mund te linde mes paleve zgjidhja eshte konsensusi, ne rast te kundert secili prej tyre ka te drejte ti drejtohet per zgjidhje Gjykates se Rrethit .

Me keto terma redaktohet kjo kontrate qeraje ne kater kopje me te njejten vlere originale secila, e pasi u lexua, u kuptua dhe u ra dakort me permbajtjen, u nenshkrua me vullnet te lire dhe pa verejtje perpara meje noterit .

Une noteri legalizoj rregullisht aktin e gjej ate konform ligjit "Per Noterine" Nr 7829, dt. 01 06 1994, neni 39/H, dhe e nenshkruaj .


PALA QERADHENESE

EDMOND GJOLEKA

Edmond Gjoleka


PALA QERAMARRESE

SHOQERIA " MARLET 2012 " shpk
Perfaqesuar nga administratorja e saj

VEDI MARLET 2012 SHPK
KRYENGRIJTJES PER
NIPT: 1233-44031
FIER


NOTER
KLEDI KËNAÇI

Kledi Kënaçi
